



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE" VLORE

VENDIM

Nr. 8, Dt. 21.05.2010

Per miratim te lejes se rinovuar, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Shushice, ne afersi te fshatit Vodice, (ne veri-lindje dhe ne lindje te tij), Komuna Kote, subjektit "Memetaj 2002" sh.p.k, Vlore.

Ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", konkretisht, neni 8 dhe 20, si dhe vendimit nr. 1 dhe nr.3 dt.21.06.2006 te K.K.U-se, duke gjykuar mbi kerkesen dhe studimin e paraqitur nga subjekti "Memetaj 2002" sh.p.k, me administrator Z. Arjan Memeti, konform formularit "F", miratuar me vendimin nr.2, dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, pasqyruar dhe ne relacionin shoqerues, paraqitur nga A.U.B "Vjose".

Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

VENDOSI:

- 1- Te miratohet Rinovimin e Lejes per shfrytezim inertesh, ne shtratin e lumit Shushice, ne afersi te fshatit Vodice,(ne pjesen veri-lindore dhe lindore te tij), Komuna Kote, subjektit "Memetaj 2002" sh.p.k, me administrator Z. Arjan Memeti, Vlore.
- 2- Siperfaqia e dhene ne shfrytezim do te jete 0.02 km² per 1 vit
E kufizuar me koodinata si me poshte:

X 1 =	44 77 415	Y 1 =	43 80 050
X 2 =	44 77 400	Y 2 =	43 80 100
X 3 =	44 77 100	Y 3 =	43 80 000
X 4 =	44 76 830	Y 4 =	43 79 845
X 5 =	44 76 635	Y 5 =	43 79 810
X 6 =	44 76 465	Y 6 =	43 79 900
X 7 =	44 75 310	Y 7 =	43 79 865
X 8 =	44 75 955	Y 8 =	43 79 420
X 9 =	44 76 000	Y 9 =	43 79 315
X10 =	44 76 310	Y10 =	43 79 650
X11 =	44 76 460	Y11 =	43 79 815
X12 =	44 76 735	Y12 =	43 79 800
X13 =	44 77 000	Y13 =	43 79 855

• *Vazhdim i Vendimit Nr. 8 , Dt.21.05.2010.*

- 3- Koha e shfrytezimit te zones do te jete ajo e percaktuar ne vendimin nr.1, dt. 21.06.2006 te K.K.U-se, nga dt.01.06.2010 deri me 31.10.2010, duke u ricikluar cdo vit, deri me dt.21.05.2012, periudhe e cila perkon me faktin qe subjekti "Memetaj 2002" sh.p.k, me administrator Z. Arjan Mameti, duhet te aplikoj per lejen e re 5 vjecare.
- 4- Volumi i materialit qe do te merret eshte 30 000 m³/vit, brenda zones qe jepet ne shfrytezim, thellesia e shfrytezimit deri ne 2 m, por jo me shume se 0.5m mbi pasqyren e ujrave fratike.
- 5- Ngarkohet A.U.B "Vjose" per zbatimin e ketij vendimi.
- 6- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"
Ardian DINE



KRYETARI I K.B.U "VJOSE"
Hasan HALILI

